

K.A.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka depozituar më 12.01.2024 pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesën për procedim disiplinor me masën “*Shkarkim nga detyra*” ndaj magjistrates K.A., gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

KLGJ pezulloi procedimin disiplinor me arsyetimin se subjekti i procedimit ishte në proces rivlerësimi kalimtar.

Këshilli i Lartë Gjyqësor në mbledhjen plenare të dt. 16.10.2024 me vendimin nr.609, ka vendosur përfundimin e procedimit disiplinor ndaj ish magjistrates K.A., pa një vendim përfundimtar. (K.A. kishte humbur statusin për shkak të largimit nga detyra gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, më 05.08.2024)